

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Modeli i Seyhanit/ Si iu "falën" 100 milionë dollarë BKT-së me bekimin e Bankës së Shqipërisë
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/modeli-i-seyhanit-si-iu-falen-100-milione-dollare-bkt-se-me-bekimin-e-i105928
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 20:11:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 20:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ae7d8c06278fc4655183914962c887c883f96ce29e5177362420983c5f62d27
TEKSTI	e859cb10a123fdab12d8f993926df796026c4f894cafbb841669092df3ac9a71
PAMJA	bbfa9eceb79b3bc4e32f39be4ebd8c80c2ecadf793cabb2873dcef461e7635d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	68ef9a743446f2d390e4e872823651e571bf91a5212dc169299f561262c65009
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	de40688aef4c4ba129d7a84fd77d2b1b27a16260a8d1d580a5a1a060453e9f69
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/68ef9a743446f2d390e4e872823651e571bf91a5212dc169299f561262c65009>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[flokuri dhe...?](#)

Policia
Shkencore,
ka

■ [nxjerr
"bilof"
Anila](#)

teresisht
historinë.
Një

■ [trupit i
shqiptarit
naa](#)

maten
mes të
mërkurës
dhe të

■ [ligjku i
kanabisit në
Shqipëri](#)

fundit,
duke
sekustruar

■ [re per
naftën/
Efekti](#)

çmimi 40 mil
euro të tjera
në vit barra
fiskale nga

■ [na
në
Se](#)

AKTUALITET

Modeli i Seyhanit/ Si iu "falën" 100 milionë dollarë BKT-së me bekimin e Bankës së Shqipërisë

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 22:00



Në fillim të vitit 2022, Bordi i Drejtorëve të Bankës Kombëtare Tregtare thirri me urgjencë dhe në panik një mbledhje jashtë radhe.

Turkoashakët që drejtonin BKT-në kishin "luajtur ruletë" dhe kishin humbur shumë para. Kjo e kishte vënë bankën më të madhe të vendit para dy zgjedhjeve. Ose të shtonte rreth 100 milionë dollarë kapital, ose të merrej nën administrim nga shteti.

Por Seyhan Pencabligil, i ardhur në Shqipëri si riosh dy dekada më parë dhe i shndërruar në mbretin e bankikut shqiptar, kishte gjetur një zgjidhje të tretë teksa rrinte pas dyerve të Bankës së Shqipërisë; ndryshimin e defterëve.

Diku mes 24 shkurtit dhe 3 marsit të vitit 2022, Bordi i Drejtorëve të BKT shpalli ndryshimin e modelit të biznesit.

(v) **Riklasifikimi i aktiveve financiare**

Banka ka bërë një riklasifikim të letrave me vlerë të mbajtura për shitje në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim ndërmjet 24 shkurtit – 3 mars 2022. Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Lartë kanë vendosur të ndryshojnë modelin e biznesit të investimeve të thesarit të njohura dhe të matura sipas SNRF 9. Ndryshimi i modelit të biznesit është shumë i rrallë për Bankën. Bazuar në modelin e ri të biznesit, objektivi i njësisë ekonomike është të mbajë pjesën më të madhe të investimeve të thesarit me koston e amortizuar e mbajtur për të mbledhur flukset e tyre monetare kontraktuale. Synimi i Menaxhmentit është vetëm të përfitojë nga

diferenca ndërmjet rendimentit të aktiveve financiare dhe koston e detyrimeve. Si i tillë, modeli i ri i biznesit nuk është për një aktiv individual, por për një nivel më të lartë agregimi që përbën një pjesë të konsiderueshme të aktiveve financiare të Bankës.

Banka Kombetare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Riklasifikimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Duke marrë parasysh sa më sipër, Banka ka riklasifikuar një pjesë të konsiderueshme të lartë të letrave me vlerë të saj në lekë dhe në valutë nga portofoli të mbajtura për shitje AFS ('Mbaj për të mbledhur dhe shitur' matur me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse) në portofolin të mbajtura deri në maturim HTM ('Mbaje për të mbledhur' matur me koston e amortizuar), me përjashtimet e mëposhtme:

Pas togëfjalëshit ekzotik të modelit të biznesit, në fakt fshihej thjesht një manovër kontabël për të zhdukur humbjet e bankës në letër. E gjithë manovra lidhej me investimet masive që BKT kishte bërë në letrat me vlerë, bono të qeverisë shqiptare dhe ato të qeverive të huaja.

Riklasifikim 1 miliardë dollarë

Në fund të vitit 2021, BKT kishte një total asetesh prej 5.2 miliardë dollarësh. Por gjysma e këtij portofoli ose 2.6 miliardë dollarë ishin investime në letra me vlerë, pra bono të qeverisë shqiptare dhe atyre të huaja.

Në financë ekziston një rregull i artë. Kur normat e interesit në treg rriten, vlera e letrave me vlerë ekzistuese bie. Problemi ishte se në atë kohë normat e interesit në treg po rriteshin me shpejtësi, teksa bankat qendrore po përpiqeshin të mbanin dallgën e madhe inflacioniste të shkaktuar nga lufta në Ukrainë.

Kur letrat me vlerë mbahen me vlerën e tregut, siç i kishte BKT, rritja e interesave përkthehet automatikisht në ulje të vlerës së tyre dhe humbje në bilanc.

Për të mbrojtur veten nga kjo rënie e madhe që po gërryente kapitalin e saj, bordi i drejtorëve të BKT-së riklasifikoi 947 milionë dollarë letra me vlerë nga bonde të mbajtura me vlerë tregu, në bonde të mbajtura deri në maturim.

Objektivi i Bankës është që letrat me vlerë me vlerësim më të ulët të kredisë dhe maturitete afatgjata (me rrezik më të lartë), si dhe të kenë një vlerësim në kohë reale të shënuar në treg, nuk duhet të mbahen në kosto të amortizuar. Ndërkohë, obligacionet e qeverisë Turke dhe Shqiptare mund të maten me koston e amortizuar, pasi përfaqësojnë vendin e origjinës së aksionerit (Turqia) dhe vendin ku BKT operon (Shqipëri). Banka ka marrë në konsideratë të gjithë informacionin e disponueshëm në momentin e vendimit për ndryshimin e modelit të saj të biznesit.

Rrjedhimisht, portofoli i letrave me vlerë i matur me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse u përgjysmua në shkurt-mars 2022 duke kontraktuar vlerën nominale në 947 milionë dollarë, nga të cilat 615 milionë dollarë nga portofoli i lekëve dhe 332 milionë dollarë nga portofoli i valutës. Pas ndryshimit të modelit të biznesit dhe riklasifikimit pasues të aktiveve të tij financiare, pjesa e vlerës nominale të letrave me vlerë të investimit e matur me kosto të amortizuar ndaj totalit të portofolit të letrave me vlerë (pa përfshirë bonot e thesarit) në bazë të konsoliduar arriti në 62% më 31 dhjetor 2022 (31 Dhjetor 2021: 9%), ndërsa pjesa e letrave me vlerë të investimeve të matura me vlerën e drejtë u tkurr në 38% më 31 dhjetor 2022 (31 dhjetor 2021: 91%).

Paragrafi 4.4.1 kërkon që një njësi ekonomike të riklasifikojë aktivet financiare nëse njësia ekonomike ndryshon modelin e saj të biznesit për administrimin e këtyre aktiveve financiare. Ndryshime të tilla pritet të jenë shumë të rralla. Ndryshime të tilla përcaktohen nga drejtuesit e lartë të njësisë ekonomike si rezultat i ndryshimeve të jashtme ose të brendshme dhe duhet të jenë të rëndësishme për operacionet e njësisë ekonomike dhe të demonstrueshme për palët e jashtme.

Por çfarë do të thoshte kjo në praktikë?

Duke deklaruar zyrtarisht se ne nuk do t'i shesim këto letra me vlerë përpara afatit, por do t'i mbajmë derisa shteti të na kthejë paratë në fund të afatit të maturimit, BKT fitoi të drejtën ligjore kontabël që të mos i pasqyronte më humbjet nga luhatjet e përditshme të çmimeve në treg.

BSH mbylli sytë

Vendim i brendshëm i Bordit të Drejtorëve të BKT për të riklasifikuar 1 miliardë dollarë letra me vlerë iu dorëzua Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë si pjesë e raportimeve të

detyrueshme periodike. BSH e pranoi kete argumentim si te vlershem tigrerisht nen ombrellen e rregullave te IFRS 9.

Por kjo ishte një farsë për të cilën Banka e Shqipërisë ishte plotësisht e vetedijshme. Në fakt, BKT nuk ishte banka e vetme që u përball me këtë problem.

Shumë banka europiane, sidomos në Eurozonë, pësuan të njëjtat humbje të fshehura si BKT. Mirëpo, Banka Qendrore Europiane dhe Autoriteti European i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve mbajtën një qëndrim shumë agresiv.

Rregullatorët në BE deklaruan se rritja e thjeshtë e interesave apo kriza e tregut ishte një rrezik makroekonomik, jo ndryshim real i strukturës operative të bankave. Ata paralajmëruan bankat se nëse do të guxonin të riklasifikonin letrat e tyre thjesht për të fshehur humbjet kontabël, do të përballeshin me penalitete të rënda rregullatore dhe mos-njohje të pasqyrave financiare.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Silicon Valley Bank, banka e famshmë që mbante paratë e sektorit të teknologjisë u çua në falimentim pikërisht për këtë fakt. Sepse nuk i lejuan riklasifikimin e aseteve që mbantë në letra me vlerë.

Në rastin e Shqipërisë, BSH u tregua më pragmatike dhe tolerante sesa BQE-ja në Frankfurt. Duke qenë se tregu shqiptar është i vogël dhe i ndjeshëm, rregullatori vendas lejoi një interpretim më fleksibël të IFRS 9 për BKT-në dhe disa banka të tjera, duke pranuar se goditja e vitit 2022 përbënte një forcë madhore që legjitimonte ndryshimin e modelit të menaxhimit të thesarit.

Nëse do të ndiqeshin standardet e rrepta të BQE-së, lëvizja e BKT-së me shumë gjasa do të ishte bllokuar që në zanafillë.

Dividentët e Seyhanit

Nëse Banka e Shqipërisë nuk do të kishte pranuar riklasifikimin e letrave më vlerë, BKT do të detyrohej të shtonte rreth 100 milionë dollarë kapital në mënyrë urgjente.

Kjo pasi në momentin fillestar të riklasifikimit (shkurt-mars 2022), humbja e pa-realizuar nga rënia e vlerës së bondeve të BKT llogaritej rreth 40.8 milionë USD, ndërsa deri në fund të vitit 2022 ajo arriti në 90 milionë dollarë.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Riklasifikimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Portofoli i riklasifikuar	Vlera nominale (monedhë origjinale)	Vlera nominale (ekuivalent në USD)	Fitim/(humbja) nga vlera e drejtë (ekuivalent në USD)				
			Në datën e riklasifikimit	30-06-22	30-09-22	31-12-22	28-02-23
ALL	65,790,000,000	614,572,630	30,923,490	9,753,755	(21,382,583)	(29,632,131)	(4,467,905)
USD	131,000,000	131,000,000	(5,473,107)	(26,840,582)	(25,103,504)	(22,849,911)	(21,906,725)
EUR	156,500,000	166,996,684	(1,330,139)	(10,507,538)	(11,455,157)	(8,623,182)	(8,681,811)
GBP	28,352,000	34,144,230	(893,677)	(2,332,516)	(3,831,449)	(2,905,797)	(2,593,809)
Total		946,713,544	23,226,567	(29,926,881)	(61,772,693)	(64,011,021)	(37,650,250)

Vlerat e mësipërme në monedhë origjinale janë konvertuar në mijë Lek ekuivalent duke përdorur kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën 31 dhjetor 2022.

Karta e krizes se BKT

Këto humbje duheshin zëvendësuar me injektim kapitali për të mbajtur parametrat e kapitalit të BKT-së në vlerat e kërkuar nga ligji. Por BKT nuk derdhi asnjë lek sepse riklasifikoi titujt.

Shpëtimi financiar, që BSH i bëri BKT-së ishte një hap i domosdoshëm për të mos zhytur sistemin bankar në krizë financiare. Por ajo që ndodhi më pas ishte një perversitet.

Një muaj pasi Bordi Drejtues i BKT riklasifikoi letrat me vlerë për të zhdukur humbjen në letër, drejtuesit e saj ndanë 50 milionë dollarë dividendë për pronarin në Turqi. Kjo ishte shkelje syri.

BKT ishte shumë e madhe për t'u rrëzuar. Në anglisht termi është "too big to fail". Rrjedhimisht ndodhi e pashmangshmja. Fitimet për Seyhanin me Çalikun, kurse humbjet për publikun.

Madje, me paturpësi, drejtori ekzekutiv i BKT deklaroi publikisht se viti 2022 ishte një rekord historik për BKT-në.

"Viti 2022 ishte një vit rekordesh ku BKT arriti fitimin më të lartë historik."

Seyhan Pencabliligil
Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar Bordi





Por fitimet e BKT-së në vitin 2022 erdhën nga shkelja e rregullave dhe tolerimi i saj. Prandaj BKT nuk bën ndërmjetësim financiar sipas rregullave të tregut, por thjesht merr paratë e qytetarëve dhe ble bono të qeverisë. Me pak fjalë fitime të garantuara në dëm të ekonomisë.

Ky është modeli i Seyhanit, i cili është i sigurtë se edhe kur luan ruletë, dikush do ja shpëtojë të ndenjurat./kapitali

Galeria fotografike ()

(v) Riklasifikimi i aktiveve financiare

Banka ka bërë një riklasifikim të letrave me vlerë të mbajtura për shitje në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim ndërmjet 24 shkurtit – 3 mars 2022. Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Lartë kanë vendosur të ndryshojnë modelin e biznesit të investimeve të thesarit të njohura dhe të matura sipas SNRF 9. Ndryshimi i modelit të biznesit është shumë i rallë për Bankën. Bazuar në modelin e ri të biznesit, objektivi i njësish ekonomike është të mbajë pjesën më të madhe të investimeve të thesarit me koston e amortizuar e mbajtur për të mbledhur flukset e tyre monetare kontraktuale. Synimi i Menaxhmentit është vetëm të përfitojë nga diferenca ndërmjet rendimentit të aktiveve financiare dhe koston e detyrimeve. Si i tillë, modeli i ri i biznesit nuk është për një aktiv individual, por për një nivel më të lartë agregimi që përbën një pjesë të konsiderueshme të aktiveve financiare të Bankës.

13

Banka Kombetare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shprehur në USD, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Riklasifikimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Duke marrë parasysh sa më sipër, Banka ka riklasifikuar një pjesë të konsiderueshme të lartë të letrave me vlerë të saj në lekë dhe në valutë nga portofoli të mbajtura për shitje AFS (Mbaj për të mbledhur dhe shitur' matur me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse) në portofolin të mbajtura deri në maturim HTM (Mbaj për të mbledhur' matur me koston e amortizuar), me përjashtimet e mëposhtme:

Objektivi i Bankës është që letrat me vlerë të investimit të ulët të kredisë dhe maturitete afatgjata (me rrezik më të lartë), si dhe të kenë një vlerësim në kohë reale të shënuar në treg, nuk duhet të mbahen në kosto të amortizuar. Ndërkohë, obligacionet e qeverisë Turke dhe Shqiptare mund të maten me koston e amortizuar, pasi përfaqësojnë vendin e origjinës së aksionerit (Turqia) dhe vendin ku BKT operon (Shqipëri). Banka ka marrë në konsideratë të gjithë informacionin e disponueshëm në momentin e vendimit për ndryshimin e modelit të saj të biznesit.

Rrjedhimisht, portofoli i letrave me vlerë i matur me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse u përgjysmua në shkurt-mars 2022 duke kontraktuar vlerën nominale në 947 milionë dollarë, nga të cilat 615 milionë dollarë nga portofoli i lekëve dhe 332 milionë dollarë nga portofoli i valutës. Pas ndryshimit të modelit të biznesit dhe riklasifikimit pasues të aktiveve të tij financiare, pjesa e vlerës nominale të letrave me vlerë të investimit e matur me kosto të amortizuar ndaj totalit të portofolit të letrave me vlerë (pa përfshirë bonot e thesarit) në bazë të konsoliduar arriti në 62% më 31 dhjetor 2022 (31 Dhjetor 2021: 9%), ndërsa pjesa e letrave me vlerë të investimeve të matura me vlerën e drejtë u tkurr në 38% më 31 dhjetor 2022 (31 dhjetor 2021: 91%).

Paragrafi 4.4.1 kërkon që një njësi ekonomike të riklasifikojë aktivet financiare nëse njësia ekonomike ndryshon modelin e saj të biznesit për administrimin e këtyre aktiveve financiare. Ndryshime të tilla pritet të jenë shumë të ralla. Ndryshime të tilla përcaktohen nga drejtuesit e lartë të njësish ekonomike si rezultat i ndryshimeve të jashtme ose të brendshme dhe duhet të jenë të rëndësishme për operacionet e njësish ekonomike dhe të demonstrueshme për palët e jashtme.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Riklasifikimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Portofoli i riklasifikuar	Vlera nominale (monedhë origjinale)	Vlera nominale (ekuivalent në USD)	Fitim/(humbja) nga vlera e drejtë (ekuivalent në USD)				
			Në datën e riklasifikimit	30-06-22	30-09-22	31-12-22	28-02-23
ALL	65,790,000,000	614,572,630	30,923,490	9,753,755	(21,382,583)	(29,632,131)	(4,467,905)
USD	131,000,000	131,000,000	(5,473,107)	(26,840,582)	(25,103,504)	(22,849,911)	(21,906,725)
EUR	156,500,000	166,996,684	(1,330,139)	(10,507,538)	(11,455,157)	(8,623,182)	(8,681,811)
GBP	28,352,000	34,144,230	(893,677)	(2,332,516)	(3,831,449)	(2,905,797)	(2,593,809)
Total		946,713,544	23,226,567	(29,926,881)	(61,772,693)	(64,011,021)	(37,650,250)

Vlerat e mësipërme në monedhë origjinale janë konvertuar në mijë Lek ekuivalent duke përdorur kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën 31 dhjetor 2022.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.